




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË
INSTITUTE OF CRIMES COMMITTED DURING THE WAR IN KOSOVO
INSTITUTU ZA ZLOČINE POČINJENE TOKOM RATA U KOSOVU



INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË (IKKL)

RAPORT VJETOR I PUNËS

(8 nëntor 2023 – 8 nëntor 2024)

MISIONI

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) ka mision dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës nga aspekti historik, ushtarak, ekonomik, juridik, ekologjik, kulturor, psikologjik, mjeko-ligjor dhe sociologjik, përfshirë aspektet e tjera me rëndësi për dokumentimin dhe hulumtimin e këtyre krimeve, në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-177 për IKKL-në.

IKKL është agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-177, IKKL ka kompetencë dhe përgjegjësi që të dokumentojë dhe hulumtojë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. IKKL siguron të dhëna mbi humbjet në jetë, dëmet fizike dhe psikologjike, dëmet ekonomike dhe materiale, si dhe dëmet ndaj ambientit dhe pronës kulturore (figura i).




Figura i. Klasifikimi i krimeve të luftës për qëllime të dokumentimit dhe hulumtimit

LIGJI

Ligji Nr. 08/L-177 ka për qëllim themelimin, organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e kompetencave të IKKL-së (“Instituti”).

FUSHËVEPRIMET DHE AFATI KOHOR

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen me qëllim të kryerjes së dokumentimit dhe hulumtimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, nga 1 janar 1998 deri më 20 qershor 1999 (“periudha e luftës”).
2. Dokumentimi dhe hulumtimi nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të aplikohet edhe mbi krimet e kryera pas periudhës së luftës, të ndërlidhura me luftën, jo më vonë se me datën 31 dhjetor 2000.
3. Pa paragjykuar paragrafin 2 të këtij neni, Instituti do dokumentojë dhe hulumtojë edhe krimet e veprimet tjera që kanë shpënë te lufta në Kosovë, me qëllim të paraqitjes së plotë të fakteve që ndërlidhen drejtpërdrejt me luftën (figura ii).




Figura ii. Konteksti kohor dhe gjeografik i fushëveprimtarisë së IKKL-së



Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, **Kofi Annan**, më 30 mars 1999, në UNHCR, Daily Highlights, veprimet serbe në Kosovë i quajti ***“Fushatë sistematike e spastrimit etnik nga ushtria serbe dhe grupet paramilitare në Kosovë”***. Pak më vonë, më 9 prill 1999, në Gjenevë ai deklaroi: ***„Ndodhemi nën renë e errët të krimit të gjenocidit”***, dhe shtoi se Këshilli i Sigurimit nuk guxon të bëhet një strehimore për ata që nën pretekstin e sovranitetit ndërmarrin shkeljet më të këqija kundër të drejtave të njeriut.



¹ Krah. A. A. Steinkamm, Völkerrecht, Humanitäre Intervention und Legitimation des Bundeswehr-Einsatzes, Völker- und wehrrechtliche Aspekte des Kosovo-Konflikts 1999 [E drejta ndërkombëtare, intervenimi humanitar dhe legjitimimi i angazhimit të ushtrisë gjermane, aspektet e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës ushtarake të konfliktit të Kosovës], në: Südosteuropa 5-6/2000, f. 242. Krah. deklarata të mëtejme të K. Annan në lidhje me krimet e kryera në Kosovë, në të cilat mes tjerash fjala është për „vrasjet masive të civilëve në Kosovë”, në: UN Doc. S/1998/192 nga 3 tetori 1998 dhe UN Doc. S/1999/293 nga 17 mars 1999; Më tutje krahaso rreth kësaj „Deklaratën e Këshillit Evropian për Kosovën” dhe sqarime, deklarime etj. të shumta të publikuara në lidhje me këtë, në: Internationale Politik – Europa Archiv 5/1999, Dokumentation/Dokumente zum Konflikt auf dem Balkan [Dokumentacion/dokumente rreth konfliktit në Ballkan].

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) është themeluar më 8 nëntor 2023, kur Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, emëroi Drejtor Ekzekutiv të IKKL-së, Dr. Atdhe Hetemin. Baza ligjore që mbështet themelimin dhe funksionimin e IKKL-së është Ligji Nr. 08/L-177. Drejtori Ekzekutiv ka mirëpritur shërbyesin e parë civil në muajin prill 2024 ndërsa gjatë pesë (5) muajve të pare, IKKL-ja ka funksionuar pa asnjë shërbyes civil. Megjithatë, gjatë periudhës 8 nëntor 2023 – 8 nëntor 2024, IKKL ka arritur të realizojë një sërë objektivash të rëndësishme. Disa prej të arriturave kryesore të IKKL-së gjatë këtij viti përfshijnë:

- Zhvillimi dhe implementimi i gjithsej 7 dokumenteve të rëndësishme, që kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe metodologjike të institucionit. Këto rregullore janë thelbësore për garantimin e një funksionimi të rregullt dhe transparent;
- Sigurimi i hapësirave dhe kushteve optimale për punë, për stafin e IKKL-së. Po ashtu, është krijuar Arkiva e IKKL-së, me një sipërfaqe prej 48.1 m², e pajisur me raftet dhe teknologjinë më moderne për ruajtjen e dokumentacionit;
- Nga 38 konkurse të shpallura përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), janë trajtuar 1210 aplikacione dhe janë rekrutuar 24 zyrtarë/e, ndërsa në proces të rekrutimit janë edhe 18 punonjës të tjerë. Ky proces ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe në krijimin e një ekipi profesional dhe efikas. Gjatë vitit, gjithashtu janë organizuar trajnime të ndryshme për stafin, të cilat janë mbajtur nga IKAP, Thesari i Kosovës dhe CTP Consulting;
- Mbledhja e një sasie të konsiderueshme të materialeve, që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, respektivisht mbi 189.5 metra gjatësi e materialit arkivor, mbi 14.64 TB materiale digjitale dhe rreth 200 video kaseta (AVC).
- Lidhja e 8 memorandumeve bashkëpunimi me institucione lokale dhe rajonale, duke forcuar kështu lidhjet dhe koordinimin me akterët e tjerë për avancimin e projekteve dhe iniciativave të përbashkëta;
- Promovimi i kërkimeve shkencore për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, përmes inicimit të publikimit të 'Edited Volume' ku janë pranuar 17 abstrakte, nga universitete dhe autorë të njohur. Pas vlerësimit, 12 abstrakte janë miratuar dhe është strukturuar përmbajtja e vëllimit editorial;
- Përveç aktiviteteve kombëtare dhe rajonale, IKKL është përfaqësuar në 8 konferenca dhe panele diskutimi, duke promovuar aktivitetet dhe arritjet e tij. Pjesëmarrja në këto ngjarje është një mundësi e mirë për shkëmbim idesh dhe praktikash më të mira me profesionistë të tjerë. Gjithashtu, IKKL ka kontribuar me materiale në ekspozita ndërkombëtare, me qëllim të njohjes globale të Institutit.

Për vitin 2025, prioritetet kryesore të IKKL-së përfshijnë funksionalizimin e plotë të strukturave administrative të tij, intensifikimin e mbledhjes së materialeve dhe implementimin e plotë të projektit të digjitalizimit. Realizimi i këtyre objektivave kërkon mbështetje të vazhdueshme nga Zyra e Kryeministrit dhe ministritë përkatëse, si dhe miratimin e një buxheti të plotë që do të sigurojë burimet e nevojshme për funksionimin efikas të Institutit.

PËRMBAJTJA

1	Korniza legjislativë, metodologjike dhe etike	5
1.1	Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës	5
1.2	Metodologjia e dokumentimit dhe hulumtimit	6
1.3	Terminologjia	7
1.4	Plani i projektit të digjitalizimit	8
1.5	Vlerat themelore të sjelljes profesionale	8
1.6	Manuali i punëtorit	9
1.7	Marrëveshja për ruajtjen e sekretit dhe moszbulimin e informatave	9
2	Zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe burimeve njerëzore	10
2.1	Infrastruktura dhe logjistika	10
2.2	Stafi dhe burimet njerëzore	10
2.3	Trajnimi dhe zhvillimi profesional	11
3	Veprimet bashkëpunuese: integrimi horizontal dhe vertikal	12
3.1	Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional	12
3.2	Popullimi i arkivit	12
3.3	Bashkëpunimi me institucionet shtetërore	12
3.4	Marrëveshjet lokale dhe rajonale të bashkëpunimit	14
4	Promovimi institucional dhe kontributi akademik ndërkombëtar	15
4.1	Identiteti, prania digjitale dhe mediat sociale	15
4.2	Prezantime mediatike	15
4.3	Prezantime dhe angazhime lokale dhe ndërkombëtare	16
4.4	Kontributi shkencor përmes “Open Call for Papers – Edited Volume”	16
4.5	Ekspozitat ndërkombëtare dhe promovimi kulturor	17
5	Raporti financiar	18
5.1	Përmbledhje të zhvillimeve kryesore për buxhetin	18
6	Sfidat operative	19
6.1	Mungesa e burimeve njerëzore	19
6.2	Vështirësi në rekrutimin e stafit	19
6.3	Ndërtimi i besimit publik	19
6.4	Pengesat burokratike dhe logjistike	19
7	Prioritetet strategjike për 2025	20
7.1	Implementimi i projektit të digjitalizimit	20
7.2	Intensifikimi i mbledhjes dhe verifikimit të materialeve	20

7.3	Rritja e ndërgjegjësimit publik.....	20
7.4	Funksionalizimi i plotë.....	20
8	Kërkesat kryesore për vitin 2025.....	21
8.1	Miratimi i buxhetit për 2025.....	21
8.2	Lirimi i hapësirave dhe krijimi i depove arkivore.....	21
8.3	Vazhdimi i mbështetjes nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë përkatëse	21

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organogrami i IKKL-së	6
Figura 2. Hapat metodologjikë të përfshirë në punën e Departamentit të Dokumentimit	7
Figura 3. Fazat e përfshira në procesin e punës së Departamentit të Hulumtimit	7
Figura 4. Dizajni i infrastrukturës së nivelit të lartë për ruajtjen dhe arkivimin aktiv digjital	8
Figura 5. Vlerat themelore të sjelljes profesionale në IKKL	9
Figura 6. Shpërndarja demografike e stafit sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe nivelit të shkollimit	11
Figura 7. Përmbledhje e burimeve të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL	12
Figura 8. Harta e komunave me të cilat IKKL ka nënshkruar protokolle bashkëpunimi dhe të cilat, njëkohësisht kanë dorëzuar materiale arkivore në IKKL	13
Figura 9. Audienca në medie sociale (Facebook) sipas moshës dhe gjinisë	15
Figura 10. Buxheti fillestar dhe i shpenzuar i IKKL-së	18

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Aktet e aprovuara juridike	5
Tabela 2. Shpërndarja e pozitave dhe plani i rekrutimit sipas kategorive për vitin 2024-2025	10
Tabela 3. Memorandumet e bashkëpunimit	14
Tabela 4. Përfaqësimi i IKKL-së në konferenca dhe panele diskutimi	16
Tabela 5. Struktura e përmbajtjes së vëllimit editorial të IKKL-së	17

1 Korniza legjislativë, metodologjike dhe etike

Me 8 nëntor 2023, në dispozicion për qëllimin e themelimit dhe funksionalizim të IKKL-së ka qenë vetëm Ligji Nr. 08/L-177. Gjatë periudhës 8 nëntor 2023 – 8 nëntor 2024, IKKL ka punuar intensivisht për të krijuar një kornizë të plotë rregullative, metodologjike, terminologjike dhe etike, e cila do të shërbejë si bazë për të gjitha aktivitetet e ardhshme të IKKL-së. Kjo kornizë përfshin dokumente që sigurojnë një strukturë të qartë organizative për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës. Të gjitha këto dokumente vendimtare për punën e IKKL-së, janë përgatitur në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse, pjesë e institucioneve shtetërore, Universitetit të Prishtinës, Akademisë së Shkencave, shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë, etj. Kjo gjithëpërfshirje është synuar me qëllim që IKKL, si institucion të përmbushë standardet më të larta profesionale ndërkombëtare, si dhe nevojat lokale.

Nga themelimi, IKKL ka zhvilluar dhe implementuar disa akte juridike (shih tabelën 1) që kanë për synim forcimin legjislativ, metodologjik dhe etik:

Tabela 1. Aktet e aprovuara juridike

Nr.	Akti juridik	Data e aprovimit	Përshkrimi
1.1	Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës	14.02.2024	Rregullorja përcakton hierarkinë, funksionet dhe përgjegjësitë e vendeve të punës, duke siguruar efikasitetin dhe koordinimin brenda Institutit.
1.2	Metodologjia e dokumentimit dhe hulumtimit	Pritet me dt. 30.11.2024	Dokumenti përcakton metodologjinë që duhet ndjekur për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.
1.3	Terminologjia	Pritet me dt. 30.11.2024	Dokumenti përcakton termat qartë, saktë dhe të lehtë të kuptueshëm, që duhet përdorur përgjatë dokumentimit dhe hulumtimit.
1.4	Plani i projektit të digjitalizimit	06.06.2024	Projekt i detajuar për digjitalizimin dhe ruajtjen e dokumentacionit mbi krimet e luftës, duke siguruar qasje të lehtë dhe të sigurt për hulumtuesit.
1.5	Vlerat themelore të sjelljes profesionale	17.09.2024	Rregullorja përcakton standardet etike dhe sjelljet e pritura, që nxisin profesionalizmin dhe integritetin, në ambientin e punës.
1.6	Manuali i punëtorit	31.10.2024	Manuali është udhëzues gjithëpërfshirës dhe i qartë për ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe pritshmëritë e IKKL-së, në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore.
1.7	Marrëveshja për ruajtjen e sekretit dhe moszbulimit të informatave	31.10.2024	Marrëveshja synon ruajtjen e konfidencialitetit të informatave të ndjeshme.

1.1 Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës

IKKL ka përgatitur *Rregulloren* ZKM -Nr. 04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IKKL, e cila është miratuar nga Kryeministri z. Kurti, me Vendimin Nr. 017/2024, të datës 14.02.2024. Kjo rregullore ka qenë thelbësore për të vendosur një strukturë të qartë dhe të organizuar për funksionimin e brendshëm të IKKL-së, dhe përcakton mënyrën e organizimit të departamenteve dhe divizioneve. Siç mund të shihet nga figura nr. 1, IKKL përbëhet nga tre Departamente: i) Departamentin e Dokumentimit (përgjegjës për mbledhjen, verifikimin, përpunimin si dhe arkivimin e të dhënave që dokumentojnë krimet të kryera gjatë luftës në Kosovë), ii) Departamentin e Hulumtimeve (përgjegjës për planifikimin dhe

zhvillimin e hulumtimeve profesionale dhe akademike me qëllim të krijimit dhe publikimit të të dhënave shkencore rreth krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, nevojave të viktimave dhe dëmeve të shkaktuara nga krimet) dhe iii) Departamentin e Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme (përgjegjës për çështjet operative, brenda IKKL-së).




Figura 1. Organogrami i IKKL-së

Kjo rregullore u përgatit me kontributin e Zyrës Ligjore të ZKM-së, por u diskutua edhe me përfaqësues nga institucione të drejtësisë, organizatave joqeveritare, akademikë nga Universiteti i Prishtinës dhe ekspertë të fushës, duke siguruar që struktura organizative të jetë e aplikueshme. Rregullorja përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e departamenteve, divizioneve dhe stafit të IKKL-së, për të siguruar një funksionim efikas dhe të qëndrueshëm.

1.2 Metodologjia e dokumentimit dhe hulumtimit

IKKL ka prodhuar një *dokument metodologjik* të hollësishëm për dokumentimin dhe hulumtimin e të dhënave që lidhen me krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Kjo metodologji është thelbësore për mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe arkivimin e materialeve (dokumente, video, foto dhe audio), si dhe për drejtimin e hulumtimeve që ndihmojnë në dokumentimin e krimeve të luftës. Metodologjia është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë lokalë, rajonalë si dhe ndërkombëtarë (duke përfshirë ekspertë të fushës, përfaqësues të OJQ-ve, akademikë nga Kosova, Shqipëria, Bosnia, Japonia, Norvegjia, Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Polonia, etj.), për të siguruar që çdo fazë e këtij procesi përmbush standardet më të larta profesionale. Metodologjia për dokumentimin përqendrohet në mënyrën e mbledhjes, verifikimit, përpunimit dhe arkivimit të të dhënave (figura 2). Qëllimi kryesor i metodologjisë është që ajo të shërbejë si filtër metodologjik, mbi bazën e të cilit do të dokumentohen në mënyrën më kredibile, krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.




Figura 2. Hapat metodologjikë të përfshirë në punën e Departamentit të Dokumentimit

Kurse pjesa për hulumtimin, fokusohet në përdorimin e materialeve të dokumentuara, për të zhvilluar analiza dhe studime të thelluara mbi krimet e kryera gjatë luftës (figura 3). Kjo metodologji është gur themeli kryesor për të gjitha aktivitetet dokumentuese dhe hulumtuese të IKKL-së, dhe garantuese që proceset brenda IKKL-së janë të qëndrueshme, të strukturuar dhe të besueshme.



Figura 3. Fazat e përfshira në procesin e punës së Departamentit të Hulumtimit

1.3 Terminologjia

Për të siguruar saktësi dhe konsistencë në përdorimin e termave dhe kontekstit specifik të krimeve të luftës në Kosovë, IKKL ka përgatitur një dokument të veçantë të *terminologjisë*. Ky dokument është thelbësor për të mbështetur metodologjinë shkencore dhe të punës së IKKL-së, duke siguruar që kategorizimi dhe termat e përdorur në dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të jenë të qarta, të sakta dhe të lehtë të kuptueshme. *Terminologjia* e bazuar në ligjet ndërkombëtare për krimet e luftës, teoritë akademike, dhe legjislacionin lokal, përcakton saktë elementet që duhet të përmbajë një krim i caktuar, në mënyrë që të kategorizohet si “masakër”, “krim i gjenocidit”, “viktimë”, “martir”, etj. Ky udhëzues terminologjik shërben, gjithashtu për të harmonizuar gjuhën e përdorur në raportet e brendshme dhe të jashtme të IKKL-së, duke ndihmuar në ruajtjen e integritetit dhe qartësisë në komunikimin e fakteve të rëndësishme.

1.4 Plani i projektit të digjitalizimit

Një element thelbësor i ruajtjes së dokumentacionit dhe hulumtimeve mbi krimet e luftës është krijimi i një infrastrukture digjitale të qëndrueshme dhe të qasshme. Dokumenti metodologjik ka theksuar rëndësinë e mbrojtjes së materialeve dhe qasjes së lehtë për hulumtuesit dhe palët e interesuara, duke siguruar që të gjitha materialet e mbledhura të ruhen në mënyrë të sigurt dhe të jenë të disponueshme për analiza dhe publikime. Për t'i adresuar këto nevoja, më 6 qershor 2024, IKKL miratoi *projektin e detajuar për digjitalizimin e dokumentacionit*, duke vendosur një bazë të fortë për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave (figura 4). Ky projekt është thelbësor jo vetëm për të mbrojtur materialet e ndjeshme nga dëmtimi apo humbja, por edhe për të garantuar qasjen e qëndrueshme dhe të lehtë ndaj tyre. Krijimi i një sistemi të avancuar të arkivimit digjital siguron që të gjitha dokumentet, dëshmitë audio vizuale dhe materialet e tjera të ruajtura do të jenë të qasshme për hulumtues, gazetarë dhe institucione të ndryshme. Kjo qasje është vendimtare për të lehtësuar studimet shkencore, hetimet ligjore, dhe për të ndihmuar palët e interesuara të kenë një pamje të qartë të krimeve të dokumentuara. Projekti përfshin ndërtimin e një infrastrukture digjitale të sigurt që ofron përdorueshmëri të avancuar të të dhënave, duke garantuar sigurinë e materialeve përmes ruajtjes së përhershme dhe qasjes së thjeshtë, për përdoruesit e autorizuar. Ky sistem është krijuar për të integruar të dhënat me platforma të tjera qeveritare dhe për të siguruar ndërveprim të plotë me sisteme të tjera, duke rritur ndjeshëm mundësitë për kërkime dhe analiza të detajuara. Miratimi i këtij projekti shënon një hap të rëndësishëm për të ardhmen e dokumentimit dhe hulumtimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Aplikimi i kësaj platforme të sigurt dhe të qasshme për të gjithë ata që kërkojnë të shfrytëzojnë këto materiale, ka për qëllim avancimin e analizave të specializuara shkencore, ligjore, historike, etj.




Figura 4. Dizajni i infrastrukurës së nivelit të lartë për ruajtjen dhe arkivimin aktiv digjital

1.5 Vlerat themelore të sjelljes profesionale

Me qëllim të krijimit të një mjedisi pune të sigurt, profesional dhe të respektueshëm për të gjithë, më 17 shtator 2024, IKKL miratoi një *dokument që përcakton kornizën e qartë të vlerave themelore*, të cilat do të udhëzojnë të gjitha aktivitetet e IKKL-së. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë, këto vlera janë formuluar për të garantuar që IKKL vepron me integritet dhe respekt, sidomos duke e patur parasysh ndjeshmërinë e natyrës së mandatit me të cilin është ngarkuar.

Ligjshmëria, pavarësia, paanshmëria, dhe transparencja janë përcaktuar si vlera themelore për të siguruar që të gjitha veprimet e IKKL-së janë të drejta, të pavarura nga ndikimet e jashtme dhe të hapura ndaj kontrollit publik. Përveç këtyre vlerave, etika profesionale dhe integriteti janë parime thelbësore për të gjitha veprimtaritë e IKKL-së (figura 5). Dokumenti përcakton standardet e etikës dhe sjelljes që duhet të ndjekin të gjithë zyrtarët e IKKL-së, duke siguruar që ata/ato veprojnë në përputhje me ligjin dhe me parimet e ndershmërisë dhe integritetit. Në këtë mënyrë, IKKL synon të ruajë standarde të larta profesionale dhe të krijojë një mjedis të besueshëm dhe të drejtë për të gjithë punonjësit dhe bashkëpunëtorët e brendshëm dhe të jashtëm.



Figura 5. Vlerat themelore të sjelljes profesionale në IKKL

1.6 Manuali i punëtorit

Qëllimi kryesor i *manualit të punëtorit* – i miratuar më 31 tetor 2024 - është të shërbejë si një udhëzues gjithëpërfshirës dhe i qartë për ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe pritshmërinë e IKKL-së, në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore. Ky manual synon të sigurojë që të gjithë punonjësit të kenë qasje të barabartë në informacionin e nevojshëm, për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive, dhe për të kuptuar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Përmes këtij manuali, IKKL synon të promovojë transparencën, të nxisë një kulturë pozitive të punës dhe të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve të burimeve njerëzore në mënyrë të strukturuar. Manuali për punëtorët përmban udhëzimet dhe politikat për standardet e punës, përfshirë procedurat për administrimin e dokumenteve arkivore dhe normat e etikës profesionale. Manuali ofron mbrojtje ligjore për IKKL-në, duke rritur ndërgjegjësimin e stafit që mund të shkelin rregullat e brendshme ose ligjet e jashtme, dhe duke siguruar kështu një kuptim më të mirë të përgjegjësisë dhe normave të aplikueshme.

1.7 Marrëveshja për ruajtjen e sekretit dhe moszbulimin e informatave

Marrëveshja është dokument i rëndësishëm që nënshkruhet nga i tërë stafi i IKKL-së, dhe synon ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve të ndjeshme. Kjo marrëveshje siguron që të gjithë anëtarët e stafit të trajtojnë, ruajnë dhe menaxhojnë materialet e ndjeshme në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare dhe rregulloret lokale. Duke përcaktuar qartë se çfarë përbën informacion konfidencial dhe duke përshkruar udhëzime strikte për mbrojtjen e tij, ky dokument ndihmon në ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së punës së IKKL-së, në dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Për më tepër, ai parandalon zbulimin e paautorizuar, duke mbrojtur kështu viktimat, dëshmitarët dhe natyrën e ndjeshme të materialeve kërkimore në lidhje me krimet e kryera gjatë luftës.

2 Zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe burimeve njerëzore

Në vitin 2024, IKKL ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet fizike dhe burimet njerëzore, duke përfshirë investime të mëdha në infrastrukturë, logjistikë dhe zhvillimin profesional të stafit.

2.1 Infrastruktura dhe logjistika

Me qëllim të shfrytëzimit të ekspertizës lokale sa i përket trajtimit sa më profesional të materialeve arkivore, si dhe gjetjes së hapësirave të sigurta nga rreziqet fizike dhe natyrore, me datë 7 dhjetor 2023, IKKL ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (ASHAK). Si rezultat, IKKL ka siguruar 11 zyre për sistemin e stafit, si dhe një depo arkivore prej 48.1 m², në objektin e ASHAK-ut. Nga data 1 gusht 2024, IKKL ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës fizike duke krijuar zyra të renovuara dhe duke pajisur ato me teknologji moderne për administrimin e dokumenteve arkivore. Këto investime kanë rritur ndjeshëm efikasitetin e stafit dhe funksionalitetin e përditshëm të punës. IKKL ka krijuar depo të re arkivore, që siguron ruajtjen dhe qasjen afatgjate të materialeve të mbledhura dhe të arkivuara. Ky hap dëshmon përpjekjet e rëndësishme të IKKL-së, për të krijuar hapësira të dedikuara për materialet që dëshmojnë krimet e kryera gjatë luftës, si dhe duke garantuar që ato janë të ruajtura në mënyrë të sigurt dhe lehtësisht të qasshme. Në përputhje me *Metodologjinë e Dokumentimit dhe Hulumtimit* (1.4), janë ndërmarrë masa sa i përket kategorizimit të materialeve dhe mbrojtjes së tyre nga rreziqet fizike, natyrore, kimike dhe biologjike. Përmirësimet në shërbimet logjistike përfshijnë gjithashtu dy vetura, të cilat megjithëse janë shumë pak, prapë mbesin thelbësore për transportimin e materialeve arkivore ndërmjet institucioneve dhe qendrave rajonale, si dhe për transportimin e stafit për mbledhjen e dëshmive në terren.

2.2 Stafi dhe burimet njerëzore

Drejtori Ekzekutiv ka mirëpritur shërbyesin e parë civil në muajin prill 2024, ndërsa gjatë pesë (5) muajve të pare, IKKL-ja ka funksionuar pa asnjë shërbyes civil. Në periudhën prill – qershor 2024, IKKL ka transferuar 3 zyrtarë të rinj nga institucionet të ndryshme publike. Ndërsa përgjatë muajve gusht dhe shtator të vitit 2024, në IKKL kanë filluar punën 21 zyrtarë/e të rekrutuar gjatë periudhës prill – korrik 2024. Aktualisht janë edhe 18 pozita të tjera në proces rekrutimi, gjersa zyrtarët/et që përzgjidhen pritet të fillojnë punën deri në fund të vitit 2024. Rekrutimet e përmendura më lartë janë bërë përmes konkurseve publike, të arritura pas vlerësimit të 1210 aplikacioneve për punësim të dorëzuara në IKKL përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ). Kështu, synohet që deri në fund të vitit të plotësohen 100% të objektivave të rekrutimit të parashikuara për vitin 2024 (tabela 2).

Tabela 2. Shpërndarja e pozitave dhe plani i rekrutimit sipas kategorive për vitin 2024-2025

Nr.	Kategoria	Pozitat aktuale	Në proces të rekrutimit	Rekrutimi në pritje	Planifikimi i zyrtarëve sipas Rregullores
		2024		2025	
1	Drejtues i lartë	1			
2	Drejtues i mesëm	1	2		
3	Drejtues i ulët	6	3		1
4	Profesional 1	10	9	2	24
5	Profesional 2	2	4	2	3
6	Profesional 3	2			
7	Ekspertë të jashtëm	2			
8	Ekspertë të diplomacisë qytetare	4			
TOTALI		28	18	4	28

Të dhënat e analizuara në figurën 6, paraqesin shpërndarjen demografike të stafit aktual, sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe nivelit të shkollimit, dhe dëshmojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të diversitetit në kolektiv. Për vitin 2025, është kërkuar një buxhet shtesë për të plotësuar rekrutimin e plotë të stafit, sipas rregullores së IKKL-së.




Figura 6. Shpërndarja demografike e stafit sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe nivelit të shkollimit

Gjithashtu vlen të theksohet se, që nga periudha kur kemi pasur mungesë të tërësishme të stafit, UNDP ka ofruar mbështetje me një ekspert të burimeve njerëzore (mars – dhjetor 2024) për të përmbushur detyrat kyçe në procesin e rekrutimit në IKKL. Po ashtu, IKKL ka përfituar nga ekspertët e Programit për Diplomaci Qytetare të MPJD-së, me tre ekspertë të cilët, nga muaji mars - gusht 2024, u angazhuan në fushat ligjore, metodologji shkencore dhe përgatitjen e planeve të punës. Për vitin 2024-2025, kemi zgjeruar këtë bashkëpunim me MPJD-në, duke pranuar edhe katër ekspertë të rinj që ofrojnë mbështetje të mëtejshme për aktivitetet e Institutit. IKKL ka përfunduar procesin e rekrutimit për 18 pozita të tjera të stafit të ri që do të operojë në zyrën qendrore në Prishtinë dhe në 6 rajone tjera të Kosovës. Ky zgjerim pritet të mundësojë mbledhje më të shpejtë dhe efektive të materialeve që dokumentojnë krimet e luftës, si dhe një bashkëpunim më të ngushtë me qendrat lokale.

2.3 Trajnimi dhe zhvillimi profesional

Përveç rekrutimit të Zyrtares për Trajnim dhe Këshillim Profesional, IKKL gjithashtu ka investuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të cilat janë thelbësore për zhvillimin e stafit. Trajnimet e organizuara në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), Thesarin e Kosovës dhe me CTP Consulting, kanë përmirësuar aftësitë e stafit në çështje të administrimit të përgjithshëm, në dokumentim dhe hulumtim. Si rezultat, gjatë këtij viti IKKL ka arritur që t'i funksionalizoj tre departamentet e parapara në *Rregullore* (1.1), përkatësisht Departamentin për Administratë, si dhe atë të Dokumentimit, dhe Hulumtimit.

3 Veprimet bashkëpunuese: integrimi horizontal dhe vertikal

Paralelisht me zhvillimin e infrastrukturës fizike, rekrutimin dhe trajnimin e stafit, si dhe krijimin ose zhvillimin e kornizës regullative, metodologjike e etike, gjatë një viti ekzistencë, IKKL ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh që përfshijnë partnerë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime kanë integruar partnerët tanë në mënyrë horizontale dhe vertikale, duke forcuar veprimtarinë e IKKL-së në fusha të ndryshme.

3.1 Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional

IKKL ka zhvilluar marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me institucione të ndryshme, si: ministri, komuna, institucione akademike, policinë dhe prokurorinë e Kosovës, organizatat joqeveritare, koleksionistë privat të materialeve që dëshmojnë luftën, etj. Këto lidhje të ngushta me akterë të ndryshëm kanë mundësuar një integrim horizontal, duke përfshirë partnerët tanë në sektorë të ndryshëm, për të arritur objektivat e përbashkëta të dokumentimit të krimeve të luftës. Këto partneritete kanë ndihmuar në shkëmbimin e informacionit, mbledhjen e materialeve dhe krijimin e metodologjive të përbashkëta për verifikimin e të dhënave të lidhura me krimet e luftës.

3.2 Popullimi i arkivit

Si rezultat i një rrjetëzimi dhe bashkëpunimi të frytshëm, IKKL ka arritur që me sukses të grumbullojë sasi të konsiderueshme materiale që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës. Popullimi i arkivit të IKKL-së përmes burimeve të ndryshme është një ndër të arriturat kryesore të IKKL-së për këtë vit. Gjatë periudhës raportuese, kemi mbledhur materiale nga koleksionues privatë, komuna, OJQ-të, institucione shkencore, ministri dhe institucione arkivore/bibliotekare, si në nivel lokal ashtu edhe në atë rajonal dhe ndërkombëtar (figura 7). Arkivi përfshin një numër të madh materialesh digjitale, me kapacitet total prej 14.64 TB, si dhe materiale fizike të arkivuara në një sasi prej 189.5 metra gjatësi dhe rreth 200 video kaseta (AVC). Këto kontribute kanë shtuar vlerë të madhe për arkivat tona dhe ruajtjen e trashëgimisë së krimeve të luftës.




Figura 7. Përmbledhje e burimeve të materialeve arkivore të dorëzuara në IKKL

3.3 Bashkëpunimi me institucionet shtetërore

IKKL ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me disa ministri dhe institucione shtetërore, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbështetjen e operacioneve tona. **Ministria e Drejtësisë (MD)** ka dorëzuar një sasi të konsiderueshme të materialeve që i kanë poseduar, e që përmbajnë dëshmi të krimeve të luftës. **Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)** ka ofruar mbështetje logjistike dhe praktike për IKKL-në, përfshirë mbështetje gjatë proceseve të rekrutimit të stafit dhe

zhvillimit të infrastrukturës fizike. IKKL po ashtu ka pasur një bashkëpunim të suksesshëm me **Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)**, **Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)** dhe **Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)**, të cilat kanë lidhur Institutin me komunat dhe ambasadat, duke siguruar kështu bashkëpunime lokale dhe ndërkombëtare. Në periudhën qershor - tetor 2024, IKKL nënshkroi protokolle bashkëpunimi me **24 Komuna të Kosovës**, me qëllim mbledhjen dhe ruajtjen e dokumenteve arkivore lokale (figura 8). Këto bashkëpunime synojnë të rrisin qasjen në të dhëna historike dhe të kontribuojnë në përpjekjet e dokumentimit të krimeve të kryera gjatë periudhës së luftës.



Figura 8. Harta e komunave me të cilat IKKL ka nënshkruar protokolle bashkëpunimi dhe të cilat, njëkohësisht kanë dorëzuar materiale arkivore në IKKL

3.4 Marrëveshjet lokale dhe rajonale të bashkëpunimit

Gjatë këtij viti, IKKL përmes nënshkrimit të *Memorandumeve Bashkëpunimi*, e ka formalizuar bashkëpunimin me një sërë partnerësh në nivel lokal dhe rajonal. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është rritja e kapaciteteve të përbashkëta për ndarjen e ekspertizës, përpunimin e të dhënave, organizimin e projekteve të përbashkëta, dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të Kosovës (tabela 3).

Tabela 3. Memorandumet e bashkëpunimit

Nr.	Institucioni	Data	Përshkrimi i bashkëpunimit
1	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	07.12.2023	Bashkëpunim për ndërtimin e arkivit të Institutit dhe zhvillimin e projekteve për dokumentimin e krimeve të luftës.
2	American University in Kosovo – Rochester Institute of Technology	11.03.2024	Zhvillimin e projekteve hulumtuese, konferencave, ngritjes profesionale dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale.
3	Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup	12.07.2024	Ndarja e të dhënave dhe burimeve për krimet e luftës dhe trashëgimisë kulturore.
4	Agjencia e Statistikave të Kosovës	20.09.2024	Mbledhje dhe analizim i të dhënave statistikore për periudhën e luftës.
6	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	11.10.2024	Zhvillim i projekteve edukative, hulumtuese dhe seminareve mbi krimet e luftës.
5	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	24.10.2024	Bashkëpunim për hulumtimin dhe arkivimin e dokumenteve për krimet e luftës.
7	Srebrenica Memorial Center	Në proces	Zhvillim i projekteve edukative, hulumtuese dhe seminareve. Ekspozitë e materialeve arkivore të Institutit.
8	Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë	Në proces	Shkëmbimi i materialeve arkivore dhe ekspertizës për dokumentimin e krimeve të luftës, organizimi i projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe edukative

4 Promovimi institucional dhe kontributi akademik ndërkombëtar

IKKL ka bërë përpjekje të rëndësishme për të promovuar misionin e tij, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar, përmes krijimit të identitetit të Institutit, ndërgjegjësimit mediatik, kontributeve akademike dhe pjesëmarrjes në ngjarje globale. Kjo qasje e shumëfishtë ka nxitur bashkëpunimet dhe ka rritur ndërgjegjësimin për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës.

4.1 Identiteti, prania digjitale dhe mediat sociale

Gjatë vitit 2024, IKKL ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të ndërtuar dhe forcuar identitetin e tij institucional. Si pjesë e strategjisë së marketingut, IKKL krijoi një logo zyrtare që përfaqëson vlerat dhe misionin e Institutit në dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës. Për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndarë informacione të rëndësishme me publikun, IKKL po ashtu ka hapur llogari zyrtare në platforma të ndryshme të medieve sociale, duke përfshirë Facebook, X dhe Instagram. Prania në këto platforma ka mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë dhe angazhim me një audiencë të gjerë, duke përforcuar mesazhet e Institutit dhe duke ndarë përditësime mbi aktivitetet e tij. Derisa ndjekësit e IKKL-së në Facebook kanë arritur në 3.5K, Instituti ka shënuar një ndikim të madh me një arritje prej 99.7K përdoruesish (reach). Audienca përbëhet nga grupe të ndryshme, të ndara sipas moshës dhe gjinisë, siç tregohet në figurën 9. Kjo përhapje e gjerë ka përforcuar ndërgjegjësimin për rëndësinë e dokumentimit të krimeve të luftës dhe për rolin e IKKL-së në këtë proces. Për më tepër, për të përmirësuar qasjen e publikut në informacion dhe për të zgjeruar praninë e tij online, IKKL ka krijuar dhe mirëmban uebfaqën e saj zyrtare në: www.ikkl.rks-gov.net. Kjo uebfaqe ofron burime të pasura, përfshirë raporte dhe lajme të rëndësishme, duke shërbyer si një qendër informacioni për të gjithë të interesuarit.




Figura 9. Audienca në medie sociale (Facebook) sipas moshës dhe gjinisë

4.2 Prezantime mediatike

Gjatë vitit të fundit, IKKL e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, ka qenë mjaft aktive në mediet vendore dhe ndërkombëtare. Për të promovuar misionin e Institutit dhe për të ngritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e dokumentimit të krimeve të luftës në Kosovë. IKKL është prezantuar në emisione të ndryshme lokale, si SociON dhe PRIZMA në T7, Rubikon dhe Sytë Shtatë në Klan Kosova. Edhe intervistat e rregullta në Balkan Insight, Radio Rilindja Norway, RTK, KTV, etj. kanë ndihmuar në përpjekjet e Institutit për të theksuar zhvillimin dhe objektivat e veta, si dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut.

4.3 Prezantime dhe angazhime lokale dhe ndërkombëtare

Themelimi i IKKL-së si një institucion i ri në Republikën e Kosovës, që do të shërbejë si pikë grumbullimi e të gjitha dëshmive që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, është promovuar në tetë (8) konferenca të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe në disa panele diskutimi. Prezantimet tona kanë ndihmuar në zgjerimin e ndikimit të Institutit në arenën ndërkombëtare, duke u bërë pjesë e diskutimeve shkencore për krimet e luftës (tabela 4).

Tabela 4. Përfaqësimi i IKKL-së në konferenca dhe panele diskutimi

Nr.	Konferenca	Vendi	Data
1	Konferencë me titull 'Towards a social history of Albanians in socialist Yugoslavia'	University of Graz, Austria	9-10.02.2024
2	Konferenca Ndërkombëtare e 25 vjetorit të Intervenimit të NATO-s në Kosovë	Universiteti i Prishtinës, Kosovë	31.03.2024
3	Democracy Week Conference Panel "Global Cooperation/Local Relevance: The Women, Peace and Security Agenda focus on Kosovo"	University of Adger, Kristiansand, Norvegji	06.05.2024
4	Konferencë për "Studiuesit e Evropës Qendrore dhe Juglindore"	American University, Bullgari	21.06.2024
5	Panel diskutimi "Tjetri që nuk ekziston"	Reporters House, Kosovë	17.07.2024
6	Shkolla Verore për Drejtësi Tranzicionale	Prizren, Kosovë	06.08.2024
7	Konferenca "KosovaPar"	Universiteti i Prishtinës, Kosovë	27.09.2024
8	Konferenca Ndërkombëtare "35 vjet pas rënies së regjimeve komuniste në Evropë"	Bukuresht, Rumani	03.10.2024

Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve ndërkombëtare të IKKL-së ka përfshirë takime dhe vizita studimore në Norvegji. Më 4 maj 2024, përfaqësuesit e IKKL-së vizituan Peace Research Institute Oslo (PRIO) dhe Holocaust Memorial Center në Oslo, për të shkëmbyer ekspertizë dhe për të krijuar rrjete bashkëpunimi ndërkombëtare. Po ashtu, më 7 maj 2024, ata realizuan një vizitë studimore në ARKIVET, një qendër historike në Kristiansand, duke forcuar lidhjet me institucione norvegjeze që punojnë në fushën e dokumentimit dhe arkivimit.

4.4 Kontributi shkencor përmes "Open Call for Papers – Edited Volume"

Për të nxitur studimet në fushën e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, IKKL ka iniciuar hartimin e një 'Vëllimi Editorial'. Janë pranuar 17 abstrakte nga Universitete dhe Autorë shumë prestigjioz, të cilat janë vlerësuar për publikim nga redaktorët e jashtëm Aiden Heirer dhe Furtuna Sheremeti. Pas vlerësimit, 12 abstrakte janë pranuar dhe është strukturuar përmbajtja e vëllimit editorial (tabela 5). Kjo iniciativë ka qenë një hap i rëndësishëm për të forcuar studimet akademike dhe për të nxitur bashkëpunimet me hulumtuesit nga mbarë bota. Më 17 shkurt 2025, në Prishtinë, bëhet hapja e konferencës shkencore ndërkombëtare, gjatë të cilës autorët e përzgjedhur do të prezantojnë gjetjet preliminare të hulumtimeve/artikujve të tyre.

Tabela 5. Struktura e përmbajtjes së vëllimit editorial të IKKL-së

THE SCALE, LEGACY, DOCUMENTATION, AND ADJUDICATION OF CRIMES COMMITTED IN KOSOVO		
Opening: Furtuna Sheremeti (University of Prishtina)		
Chapter I: Crimes Committed During the War in Kosovo		
Chandler Williams	Peace Research Institute Oslo (PRIO)	Even the books: destruction of Kosovar libraries
Jakob Weizman	Charles University	Drenica's Unhealed Wounds: The Elusive Quest for Justice in the KLA Stronghold
Christian Costamagna	New Europe College	Challenges in Demonstrating the Intent to Expel the Albanian Population from Kosovo through Yugoslav and Serbian State Documents (1998-1999)
Mathias Holvoet	University of Amsterdam	An Inquiry into the Nature of the Crimes Committed During the War in Kosovo
Rudinë Jakupi	Dublin City University	Bodies that don't matter: a feminist analysis of conflict-related sexual violence in Kosovo
Chapter II: Documenting and Investigating Crimes Committed During the War in Kosovo		
Anna Di Lellio	New York University	Documenting War Crimes and Crimes Against Humanity: A Gender-Attentive Strategy for Kosovo
Diego Nunez Stephanie Schwander-Sievers Melanie Klinker	Bournemouth University	Mass Grave Protection, Investigation and Engagement
Atdhe Hetemi Rona Karahoda	University of Prishtina Charles University	Comprehensive approaches to war crimes documentation: Building the foundations for sustainable peace in Kosovo
Chapter III: Addressing Crimes Committed During the War in Kosovo		
Nevenka Tromp	University of Amsterdam	The Kosovo War as Narrated in the Court Archives
Besmir Fidahić	Maastricht University	Does the realm of the international criminal tribunals think the term šiptar is ethnophaulism?
Gëzim Visoka	Dublin City University	Kosovo Specialist Chambers and the Lawfare on Self-Determination Movements
Haki Demolli	University of Prishtina	(Non)Punishment of Serbian War Criminals in Kosovo
Closing: Aidan Hehir (University of Westminster)		

4.5 Ekspozitat ndërkombëtare dhe promovimi kulturor

IKKL gjithashtu ka siguruar bashkëpunime për ekspozimin e fotografive dhe videove në qytete të mëdha ndërkombëtare si New York, Barcelona, Krakov, Paris, dhe Vancouver. Këto ekspozita kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin për krimet e luftës në Kosovë në nivel global. IKKL gjithashtu ka ofruar ndihmën e kërkuar për projektin e Reporters House në Kosovë. Për më tepër, janë siguruar hapësira në Srebrenica Memorial Center për të ekspozuar disa nga materialet tona në të ardhmen.

5 Raporti financiar

5.1 Përmbledhje të zhvillimeve kryesore për buxhetin

IKKL disponon një buxhet të pavarur, i cili menaxhohet në përputhje me ligjin përkatës. Megjithatë, administrimi dhe mbikëqyrja e buxhetit të IKKL-së bëhet nga ZKM, ndërsa buxheti final miratohet nga Kuvendi i Kosovës, pas shqyrtimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Gjatë këtij procesi, buxheti është harmonizuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, sipas direktivave të Ministrisë së Financave. Për vitin fiskal 2024, buxheti fillestar i IKKL-së, sipas Ligjit për Buxhetin, ishte 325,953.30 € (figura 10). Kjo vlerë u miratua si buxhet final, i cili u shpërnda në kategoritë: paga dhe mëditje (205,953.30 €), mallra dhe shërbime (115,000.00 €) dhe shërbime komunale (5,000 €). Deri më tani, IKKL ka shpenzuar 93.84% të buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime (107,915.14 €), dhe 99.71% të buxhetit në kategorinë shërbime komunale (4,985.65 €). Ndërsa, për shkak të faktit se një periudhë të gjatë kohore, në listë të pagave që janë paguar nga ky buxhet ka qenë vetëm Drejtori Ekzekutiv, atëherë tek kategoria paga dhe mëditje janë shpenzuar vetëm 49.46% e buxhetit (duke përfshirë llogaritjen e pagave deri në fund të vitit 2024).




Figura 10. Buxheti fillestar dhe i shpenzuar i IKKL-së

Janë shqyrtuar të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe duke marrë parasysh nevojat e IKKL-së për të realizuar misionin e tij, sipas *Ligjit* Nr. 08-L-177 dhe *Rregullores* Nr. 04-2024, buxheti i kërkuar për vitin 2025 është 3,522,529 €. Ky buxhet është thelbësor për të siguruar burimet e nevojshme që IKKL të përmbushë detyrat e tij ligjore dhe të funksionojë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

6 Sfidat operative

6.1 Mungesa e burimeve njerëzore

IKKL është përballur me sfida të konsiderueshme për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe procedurave burokratike. Për një periudhë pesë (5) mujore (nëntor 2023 – mars 2024), Drejtori Ekzekutiv menaxhoi Institutin i vetëm, duke përballuar një ngarkesë të lartë pune. Në mars 2024, UNDP ofroi mbështetje të përkohshme me një ekspert të burimeve njerëzore, ndërsa bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës siguroi tre ekspertë të angazhuar deri në gusht të 2024-tës. Megjithatë, vetëm në prill - qershor 2024, u bë i mundur transferimi i tre zyrtarëve nga institucione të tjera, të cilët u rekrutuan për të ndihmuar me operacionet e përditshme të IKKL-së.

6.2 Vështirësi në rekrutimin e stafit

Një tjetër sfidë madhore ka qenë sigurimi i stafit të kualifikuar, veçanërisht për pozitat e nivelit të mesëm, për shkak të pagave të ulëta që kanë penguar aplikimet. Megjithatë, IKKL ka bërë përparime të dukshme, duke synuar që deri në fund të vitit të plotësojë 100% të objektivave të rekrutimit. Për të rritur diversitetin dhe përfshirjen, IKKL ka rekrutuar me marrëdhënie të caktuar pune dy zyrtarë të prekur drejtpërdrejt nga lufta, njëri prej të cilëve në mënyrë individuale ka kontribuar në grumbullimin e shumë materialeve, si dhe një zyrtarë që ka qenë viktimë e dhunës seksuale dhe ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë për domosdoshmërinë e mbështetjes së të mbijetuarve të dhunës seksuale.

6.3 Ndërtimi i besimit publik

Krijimi i besimit ndërmjet qytetarëve dhe institucionit ka qenë një sfidë tjetër e rëndësishme. Proceset e drejtësisë tranzicionale dhe dokumentimi i krimeve të luftës kërkojnë përfshirje të gjerë dhe angazhim të qytetarëve. Për këtë qëllim, IKKL ka përfshirë në aktivitetet e tij individë që kanë përjetuar dhunë dhe vuajtje gjatë luftës, përfshirë viktimë të dhunës seksuale dhe ish-ushtarë të UÇK-së, të cilët kanë kontribuar duke mbledhur dëshmi dhe dokumente. Kjo qasje ka për qëllim jo vetëm të rrisë përfshirjen e qytetarëve, por edhe të forcojë lidhjen dhe besimin mes tyre dhe Institutit.

6.4 Pengesat burokratike dhe logjistike

IKKL është përballur gjithashtu me pengesa burokratike dhe interesa të ndryshme politike që kanë ndikuar në ngadalësimin e punës. Proceset administrative të ndërlikuara dhe kërkesat për dokumentacion të panevojshëm kanë shtyrë realizimin e projekteve kyçe, përfshirë vonesat për sistemin në zyre, sigurimin e automjeteve për operacione në terren, pajisjeve të punës, etj. Automjetet dhe pajisjet e tjera të punës janë thelbësore për mbledhjen e materialeve dhe transportimin e stafit. Megjithëse, vonesat e kësaj natyre kanë vështirësuar dukshëm efikasitetin, IKKL ka qenë e përkushtuar për të përmbushur misionin e tij, duke e parë këtë si një detyrë humane dhe kolektive që e bashkon ekipin dhe institucionin.

7 Prioritetet strategjike për 2025

7.1 Implementimi i projektit të digjitalizimit

Një nga prioritetet kryesore për 2025 është zbatimi i projektit të digjitalizimit. Ky projekt synon të krijojë një arkivë digjitale të sigurt për të ruajtur dhe mbrojtur të gjitha dëshmitë dhe dokumentet e mbledhura, duke siguruar qasje për studiuesit, të mbijetuarit dhe publikun ndërkombëtar. Digjitalizimi i materialeve të IKKL-së, gjithashtu mundëson hartëzimin e krimeve të kryera si dhe gjenerimin e informatave në kohe reale, që janë shumë të rëndësishme sidomos për nevoja të hulumtimeve. Digjitalizimi do të ndihmojë dukshëm në ngritjen e vetëdijes shoqërore sa i përket domosdoshmërisë që historia e krimeve të luftës të mos harrohet dhe të mbetet e qasshme për analiza të mëtejshme.

7.2 Intensifikimi i mbledhjes dhe verifikimit të materialeve

IKKL do të vazhdojë të intensifikojë përpjekjet për mbledhjen dhe verifikimin e materialeve të reja. Për më tepër synojmë që të rrisim edhe sasinë e materialeve të mbledhura nga shtetet fqinjë, (Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, etj.) Ky proces është thelbësor për të dëgjuar dhe dokumentuar historitë e viktimave dhe për të siguruar që krimet të mos fshihen nga harresa. Çdo dëshmi e verifikuar përfaqëson një hap drejt drejtësisë dhe garanton që vuajtjet e së kaluarës të mos mbeten pa u dokumentuar dhe adresuar.

7.3 Rritja e ndërgjegjësimit publik

IKKL synon të zgjerojë ndërgjegjësimin publik përmes publikimeve shkencore, analizave statistikore, videove dhe podcast-eve. Këto fushata të ndërgjegjësimit nuk kanë vetëm qëllim informimi, por edhe nxitje për reflektim dhe veprim dhe për të mbajtur gjallë kujtesën e luftës në Kosovë. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, përveç aktiviteteve të rregullta që do të implementojmë gjatë tërë vitit, me 17 shkurt 2025, është planifikuar edhe konferenca shkencore e IKKL-së në Prishtinë, si dhe pjesëmarrja në EXPO Osaka 2025, e cila do të shërbejë si një platformë e rëndësishme ndërkombëtare për të prezantuar dhe rritur ndërgjegjësimin mbi të vërtetat historike të Kosovës.

7.4 Funkcionalizimi i plotë

Funksionalizimi i plotë i IKKL-së është një tjetër prioritet i rëndësishëm. Ky proces përfshin përmirësimin e kapaciteteve, optimizimin e proceseve të brendshme dhe forcimin e bashkëpunimit me partnerët nacionalë dhe ndërkombëtarë. Vetëm përmes këtij funksionimi të plotë, IKKL do të mund të përmbushë plotësisht misionin e tij për dokumentimin e krimeve të luftës dhe drejtësinë për viktimat.

8 Kërkesat kryesore për vitin 2025

8.1 Miratimi i buxhetit për 2025


Për realizimin e këtyre objektivave, IKKL kërkon miratimin e buxhetit për vitin 2025, ku përfshihen fondet për projektet kapitale, respektivisht blerjen e softuerëve të specializuar për digjitalizim, veturat për nevojat e IKKL-së si dhe rekrutimin e stafit të nevojshëm për funksionalizim të plotë të IKKL-së. Ky buxhet është vendimtar për të mbështetur punën e IKKL-së dhe për të siguruar që historia e dhimbshme e Kosovës të dokumentohet.

8.2 Lirimi i hapësirave dhe krijimi i depove arkivore

Lirimi i hapësirave të nevojshme për stafin dhe krijimi i një depoje të dedikuar për arkivimin e materialeve është thelbësor për përmbushjen e misionit të Institutit. Aktualisht, hapësirat janë shumë të kufizuara dhe deri diku të papërshtatshme, duke penguar funksionimin efikas. Kalimi në hapësirat e reja të Agjencisë Kadastrale të Kosovës do të rrisë ndjeshëm efikasitetin operacional të IKKL-së.

8.3 Vazhdimi i mbështetjes nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë përkatëse

Mbështetja nga Zyra e Kryeministrit dhe ministritë përkatëse mbetet vendimtare për suksesin e vazhdueshëm të Institutit. Ky partneritet i ngushtë garanton që IKKL të vazhdojë të kontribuojë në ndërtimin e një të ardhmeje më të drejtë dhe të informuar për Kosovën. Pa këtë mbështetje, një pjesë e rëndësishme e misionit të IKKL-së do të jetë e rrezikuar.



info.ikkl@rks-gov.net

+383 38 200 14 359

Rr. Arbënor e Astrit Dehari, Nr. 25, Prishtina 10000, Republika e Kosovës

Website: www.ikkl.rks-gov.net

Facebook: <https://www.facebook.com/ikkl.rks>

Instagram: @ikkl_rks

X/Twitter: @ikkl_rks

